



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1567 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

VENDIM Nr. 255, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Kompleks i Ri Diplomatik i Ambasadës së Kuvajtit*", në rrugën Kuvajt/ose Zibrakëve, pranë rrugës së Elbasanit"-subjekti "Ambasada e Shtetit të Kuvajtit" përfaqësuar nga "ADXA" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Kompleks i Ri Diplomatik i Ambasadës së Kuvajtit*", në rrugën Kuvajt/ose Zibrakëve, pranë rrugës së Elbasanit"-subjekti "Ambasada e Shtetit të Kuvajtit" përfaqësuar nga "ADXA" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KOMBARI FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO